

# Rezultati i Dialogut të Brendshëm të Serbisë dhe Perspektivat e Normalizimit Gjithpërfshirës

## Hyrje

Zyrtarë qeveritarë të Serbisë kanë konfirmuar që dialogu i brendshëm i Serbisë për Kosovën është përmbyllur me një sesion të mbajtur më 31 mars 2018 me përfaqësues të shoqërisë civile. Pas shqyrtimit të rezultateve të dialogut, Presidenti i Serbisë synon t'a prezentoj platformën e tij lidhur me atë se si të zgjidhet konflikti me Kosovën. Serbia duhet të arrijë një marrëveshje përfundimtare me Kosovën në mënyrë që të përfundojë suksesshëm negociatat për anëtarësim në BE. Strategjia për Zgjerim e BE-së për Ballkanin Perëndimor që është publikuar së fundmi thekson se Beogradi dhe Prishtina duhet patjetër të nënshkruajnë një marrëveshje për normalizim gjithpërfshirës. Një marrëveshje e tillë është cak vendimtar i caktuar nga BE-ja për Serbinë. Brukseli gjithashtu është i qartë me Serbinë se tre kapituj të negociatave për anëtarësim janë më vendimtar sesa të tjerët: Kapitulli 23 dhe 24 që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit dhe të drejtat themelore dhe Kapitulli 35 që ka të bëjë me Kosovën. Udhëheqësia në Serbi thekson se është në vet interesin e Serbisë të zgjidh problemin me Kosovën, në mënyrë që të mund të vazhdojë më tutje me çështje të tjera. Për Serbët në Kosovë, normalizimi gjithpërfshirës, sipas Beogradit, duhet të prodhojë garanci për vazhdimësinë e ofrimit të sistemit edukativ të Serbisë, kujdesit shëndetësor dhe një shkallë të vetë-qeverisjes.

Ky raport përmban konkluzë nga tryeza e pestë me radhë e CIG, e mbajtur më 11 prill 2018 në Beograd lidhur me dialogun e brendshëm të Serbisë për Kosovën. Takimi ka mbledhur përfaqësues të shoqërisë civile, akademik dhe gazetarë të cilët merren me çështjet që ndërlidhen me marrëdhëniet Beograd-Prishtinë. Pjesëmarrësit diskutuan opsionet e dala nga dialogu i brendshëm për zgjidhjen e çështjes së Kosovës dhe u përcaktuan se cilat duhet të merren më seriozisht nga qeveria e Serbisë dhe presidenti.

Jemi munduar të jemi të saktë dhe të balansuar në përmbledhjen e diskutimeve, dhe kërkojmë mirëkuptim nga pjesëmarrësit komentet e të cilëve mund të mos jen përfshirë në plotëni në këtë raport të shkurtër, e për çka CIG mban përgjegjësi të plotë. Diskutimet janë mbajtur nën Rregullin Catham House. Igor Novakovic, Përfaqësues i CIG-së në Serbi ka hartuar këtë raport.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Për raportet nga tryezat kaluara të CIG-së lidhur me dialogun e brendshëm, ju lutem shihni [cigonline.net](http://cigonline.net).

## Opcionet e Dialogut të Brendshëm

Pas 21 raundeve të dialogut, grupi punues geveritar ka listuar njëmbëdhjet opzione të dala nga këto takime për zgjidhjen e çështjes së Kosovës:

1. Riintegrimi i Kosovës në rendin kushtetues të Serbisë;
2. Ndarja në vija etnike apo shkëmbimi i territoreve;
3. Ngrirja e konfliktit dhe mbajtja e status kuos;
4. Serbia nuk e njeh pavarësinë e Kosovës por vazhdon dialogun e Brukselit për të gjetur një zgjidhje praktike;
5. Një konfederatë ku Kosova bëhet njësi në konfederatë;
6. Zgjidhja e çështjeve ekonomike pa zgjidhje politike;
7. Komuniteti i kombeve të Balkanit;
8. Serbia dhe Kosova hyjnë njëkohësisht në BE, duke lënë anash qështjen e statusit;
9. Negociata me shqipëtarët e Kosovës nën patronatin e komunitetit ndërkombëtar – KB ose BE – duke u bazuar në një politikë të mos-njohjes dhe pa nënshkruar ndonjë marrëveshje;
10. Një shtet i përbashkët i shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë i bashkëqeverisur nga Shqipëria dhe Serbia;
11. Njohja e pavarësisë së Kosovës.

Sipas informacionit të njëjtë, shumica dërrmuese e pjesëmarrësve në dialogun e brendshëm kanë favorizuar opcionin numër tre, d.m.th. ngrirjen e konfliktit dhe mbajtjen e status kuos. Faza finale e dialogut është prekur nga incidenti në Mitrovicën Veriore ku Policia e Kosovës arrestoi Marko Gjuriqin, Drejtor i Zyrës për Kosovë dhe Metohi në Qeverinë e Serbisë. Mbetet e paqartë cili do të jetë hapi i radhës i qeverisë së Serbisë.

## Konkluzionet

1. Incidentet, si rasti i arrestimit të Marko Gjuriqit në Veri të Mitrovicës në vitin 2018, apo treni në vitin 2016, e largojnë nga qëllimi i tij dialogun Beograd-Prishtinë. Çdo incident është një hap mbrapa. Prandaj, udhëheqësit e Beogradit dhe Prishtinës kontribuojnë në krijimin e një atmosfere konflikti ku marrëveshja për normalizim gjithpërfshirës nuk ka kuptim. Kjo gjeneratë e serbëve dhe shqiptarëve e ka shansën që të thyej boshtin e urrejtjes dhe të mundohet të krijojë marrëdhënie mbi një bazament të ri. Një numër i pjesëmarrësve theksuan se diskursi i krijuar aktual pjesërisht i krijuar nga dialogu i brendshëm është shumë larg nga çfarë ka dashur Presidenti Aleksandër Vucic në pjesën e opinionit të tij të publikuar në të përditshem *Blic* në verën e vitit 2017 kur e ka lansuar procesin.
2. Shumica e propozimeve që rrjedhin nga dialogu i brendshëm nuk pasqyrojnë realitetin. Janë vetëm tre opzione nga lista e prezentuar nga zyrtarët qeveritar që janë reale, por që rezultojnë në pasoja të ndryshme: a) ngrirja e konfliktit dhe mbajtja e status kuos, 2) ndarja në baza etnike apo shkëmbimi i territoreve, dhe c) njohja e pavarësisë së Kosovës. Disa pjesëmarrës pohuan që janë vetëm dy opzione reale: normalizimi gjithpërfshirës si rezultat i dialogut aktual të Brukselit apo regres i marrëdhënieve dhe konflikt i ngrirë.
3. Asnjëri nga opcionet nuk e adresoi zbatimin e Marrëveshjes së Brukselit të vitit 2013 e që është të rezultojë në krijimin nga Kosova të Komunitetit/Asociacionit të komunave me shumicë Serbe dhe normalizim i plotë i marrëdhënieve, duke përfshirë mos bllokimin e

anëtarësimit të Kosovës në Kombe të Bashkuara dhe organizata tjera ndërkombëtare nga Serbia.

4. Disa folës pohuan që ndarja apo shkëmbimi i territoreve është opcioni më i keq i mundshëm dhe gjithashtu nuk është real, më së shumti për shkak të mundësisë së shkaktimit të efektit domino në rajon dhe në Evropë. Ndarja mund të shpie edhe në largim në masë të serbëve nga jugu i Kosovës, aty ku shumica e komunitetit serb jeton. Në përgjithësi interesi i serbëve në Kosovë është të shmangin ndarjen, pasi që do të zbehte pozitën e komunitetit serb në Kosovë. Për më tepër, me ribashkimin me Serbinë, veriu do të humbte të gjitha privilegjet aktuale, prandaj qytetarët në veri duhet të jenë të vetëdijshëm për këtë. Folës të tjerë pohuan se ndarja është e mirë pasi zgjidh në mënyrë të përhershme çështjen e Kosovës, çka aktualisht është shumë e rëndësishme në kontekstin gjeopolitik. Gjithsesi, komuniteti ndërkombëtar duhet të garantojë dhe të fuqizojë përpjekjet për të parandaluar mundësinë e ekzistimit të efektit domino. Disa pohuan që janë dy opsione për ndarje: Serbia merr veriuin si shkëmbim për njohje dhe ulëse në KB apo ndërrim i territoreve ku Kosova do të merrte disa pjesë të komunave Bujanoc dhe Preshevë në perëndim të Korridorit 10 (autostrada Beograd-Shkup-Selanik).
5. Të gjithë folësit u pajtuan se normalizimi nuk do të shpie në njohjen e Kosovës nga Serbia. Megjithatë disa theksuan se Serbia nuk do të mund të anëtarësohet në BE pa e njohur Kosovën. Disa pohuan që edhe njohja do të shpiente në efektin domino njësoj sikur ndarja. Sidoqoftë, në qoftë se Serbia njeh Kosovën, do të siguronte zbatimin e të drejtave dhe standardeve për Serbët në Kosovë. Në anën tjetër, në qoftë se Serbia nuk vazhdon të kundërshtojë anëtarësimin e Kosovës në KB dhe BE, nuk do të thotë që Kosova do të ketë perspektivë anëtarësimi në këto organizata. Konfrontimet e ripërtëritura SHBA-Rusi diktojnë një dinamikë të re ndërkombëtare dhe e detyron BE-në të insistojë për një proces më të shpejtë të normalizimit. Pasojat e këtijë konfrontimi mund të jenë asisoj që Rusia do të vazhdojë ta kundërshtojë anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare, veqanërisht në KB. Në anën tjetër, Spanja është në atmosferën aktuale të pas referendumit-Katalan e që ngurron të aprovojë perspektivë të qartë në KB për Kosovën.
6. Një marrëveshje gjithpërfshirëse për normalizim duhet të shpie në marrëdhënie të veçanta në mes të dy qeverive, duke përfshirë liri të plotë të lëvizjes së njerëzve dhe të mirave e shërbimeve. Sidoqoftë, nxitimi për arritje të marrëveshjes mund të shpie në rezultate të gabuara, dhe 18 muajt që disa anëtar të komunitetit ndërkombëtar përmendin për arritje të një marrëveshje të tillë nuk mjaftojnë. Qasja e drejtë do të ishte të rifillohet procesi me një dialog hapur në mes të shoqërive shqiptare dhe serbe. Pa kontakt dhe bashkëpunim në mes të të dy shoqërive nuk do të ketë zbatim të marrëveshjes gjithpërfshirëse, edhe nëse udhëheqësit arrijnë ndonjë zgjidhje vetvetiu, duke ditur që është vështirë ta “bësh publikun t’a besojë atë.”
7. Disa folës ishin skeptik që dialogu i Brukselit do të qonte në normalizim gjithpërfshirës. Në këtë fazë, ambiguiteti konstruktive është duke krijuar më shumë probleme sesa që zgjidh ato. Prandaj, Beogradi e sheh normalizimin si një proces që do të lejonte serbët e Kosovës të kenë sa më shumë lidhje që është e mundur me Serbinë dhe se nuk do të ketë njohje të Kosovës nga Serbia, përderisa për shqiptarët e Kosovës hapi përfundimtar për normalizim është njohja e Kosovës nga Serbia. Prandaj, Brukseli duhet të jetë i qartë lidhur me atë se çka është normalizimi i marrëdhënieve. Pjesëmarrësit gjithashtu kritikuan procesin pasi që nuk është duke afruar shoqëritë e Serbisë dhe Kosovës dhe në vend se të kërkojë për një marrëveshje historike që do të mbulonte të gjitha sferat e jetës dhe të sillte normalizim tek to,

po krijon pengesa dhe iu shërben politikanëve të të dy anëve si një mjet qëndrimi në pushtet. SHBA-ja, në anën tjetër, është aktori që do të mund të siguronte përmirësime substanciale të serbëve të Kosovës duke i dhënë diçka substanciale Beogradit. Kjo mënyrë e asistencës mund të avancojë procesin e normalizimit gjithëpërfshirës në një mënyrë shumë serioze.

## **Pjesëmarrësit**

**Maja Bjelos**, Hulumtues

**Nikola Burazer**, Drejtor i Programit, Qendra për Politika Bashkëkohore; Redaktor Ekzekutiv; Ballkani Perëndimor Evropian

**Gordana Delic**, Drejtor, Trusti Ballkanik për Demokraci

**Milan Igrutinovic**, Asistent Hulumtimi, Instituti për Studime Evropiane

**Verka Jovanovic**, Asistente Programi, Forumi për Marrëdhënie Etnike

**Sonja Licht**, Presidente, Fondi i Beogradit për Ekselencë Politike

**Milivoje Mihajlovic**, Zëvendës Drejtor, Radio Televizioni i Serbisë

**Dusan Milenkovic**, Kordinator i Programit, Fondacioni Westminster për Demokraci

**Petar Miletic**, Kolumnist

**Zoran Ostojic**, Gazetar

**Natasa Petrovic**, Zyrtare e Lartë e Programit, Trusti Ballkanik për Demokraci

**Aleksandra Sanjevic**, Zyrtar i Programit, Fondacioni për një Shoqëri të Hapur

**Marko Savkovic**, Drejtor Programi, Fondi i Beogradit për Ekselencë Politike

**Filip Stojanovic**, Asistent Programi, Qendra Hulumtuese për Politikë Publike

**Stefan Surlic**, Asistentë i Mësimdhënies, Fakulteti i Shkencave Politike, Universiteti i Beogradit

**Uros Teodorovic**, Zyra e Qeverisë së Serbisë për Kordinim të Marrëdhënieve në Procesin Negociator me Institucionet e Përkohshme të Vetë-Qeverisjes në Prishtinë

**Rada Trajkovic**, President, Lëvizja Evropiane e Serbëve në Kosovë

**Slobodan Zecevic**, Studiues Kryesor i Hulumtimit, Instituti për Studime Evropiane

**Jurg Benz**, Ushtrues Detyre i Misionit, Ambasada e Zvicrrës në Serbi

**Shpetim Gashi**, Zëvendës President, Këshilli për Qeverisje Gjithëpërfshirëse

**Philippe Guex**, Ambasador i Zvicrrës në Serbi

**Igor Novakovic**, Përfaqësues në Serbi, Këshilli për Qeverisje Gjithëpërfshirëse

**Alex Roinishvili Grigorev**, President, Këshilli për Qeverisje Gjithëpërfshirëse